



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 402/3 Prot.

Tiranë, më 09.04.2021

V E N D I M

Nr.37, datë 09.04.2021

“Mbi përfundimin e hetimit administrativ të nisur me kërkesën nr. 402/1 prot., datë 19.03.2021, të nëpunëses ** për detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të ekzekutojë vendimit nr. 46, datë 12.02.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës”***

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në neniet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e informacionit të protokolluar pranë Komisionerit me nr. 402/1 prot., datë 19.03.2021, për disa pretendime për paligjshmëri, të ngritura prej nëpunëses ***** në lidhje me mos ekzekutimin e një vendimi gjyqësor për sigurim padie, nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave,

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës së regjistruar me nr. 402/1 prot., datë 19.03.2021, nëpunësja ***** ka ngritur disa pretendime për parregullsi dhe shkelje të lejuara në zbatimin të nenit 510/a, të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 33, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, pasi nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk ekzekutohet një vendimi gjyqësor për sigurim padie.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur gjatë hetimit administrativ të çështjes, ka rezultuar e vërtetuar se kërkuësja ***** është punësuar pranë administratës Doganore

që prej vitit 2006 dhe është konfirmuar në vitin 2019 si nëpunëse civile në pozicionin e punës “*Specialiste pranë Sektorit të Administratës dhe Shërbimit në Degën e Doganës Durrës*”.

Me urdhrin nr.536, datë 12.01.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave është urdhëruar për nevoja të institucionit transferimi i përkohshëm i nëpunëses nga pozicioni “*Specialiste pranë Sektorit të Administratës dhe Shërbimit në Degën e Doganës Durrës*” në pozicionin e punës “*Specialiste në Sektorin Teknik në Drejtorinë Juridike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave*”.

Menjëherë sa është njohur me urdhrin nr. 536, datë 12.01.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, nëpunësja ka refuzuar transferimin e përkohshëm. Duke qenë se, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk janë marrë në konsideratë arsyet e ngritura nga nëpunësja për refuzimin e transferimit, prej tyre është lënë në fuqi urdhri i transferimit të përkohshëm.

Gjendur në këto kushte, nëpunësja i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, duke kërkuar marrjen e masës për sigurimin e padisë, për pezullimin e ekzekutimit të urdhrit nr.536, datë 12.01.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, për transferimin e përkohshëm të nëpunëses ***** në pozicionin e punës “*Specialiste në Sektorin Teknik në Drejtorinë Juridike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave*”.

Me vendimin nr. 46, datë 12.02.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka vendosur:

- *Pranimin e kërkesës së nëpunëses *****.*
- *Pezullimin e urdhrit nr. 536, datë 12.01.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Urdhër për transferimin e përkohshëm në detyrë”.*
- *Pala paditëse brenda 10 ditëve nga marrja e këtij vendimi duhet të depozitojë pranë kësaj gjykate padinë, me pasojë mosparaqitjen e padisë humbjen e fuqisë së masës së sigurimit.*
- *Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.*

Pas marrjes së këtij vendimi për sigurimin e padisë, nëpunësja nëpërmjet postës elektronike ka njohur Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me vendimin e sipërm duke kërkuar prej tyre ekzekutimin e tij.

Mirëpo, edhe pse është njohur me vendimin nr. 46, datë 12.02.2021, të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Durrës, që në kuptim të nenit 510/a, të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 33, të ligjit nr. 49/2012, “*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e*

mosmarrëveshjeve administrative” përbën titull ekzekutiv, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk e ka ekzekutuar atë.

Për këtë shkak, nëpunësja ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit që të shqyrtojë këtë rast dhe të vendosë detyrimin e institucionit që të ekzekutojë titullin ekzekutiv, vendimin nr. 46, datë 12.02.2021, të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Durrës.

Gjatë kryerjes së procesit të verifikimit të këtij rasti, është konstatuar se nëpunësja në fjalë, i është drejtuar gjykatës, për zgjidhjen përfundimtare të kësaj mosmarrëveshje.

Nisur nga ky fakt i fundit, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar sipas të cilit institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se në këtë rast, nuk duhet të vijojë më tej hetimi administrativ, pasi mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata, duke rregulluar dhe pasojat e saj.

Gjithashtu, referuar neneve 510 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, e konkretisht neni 510 të tij, subjekti i ngarkuar nga ligji për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor i cili përbën titull ekzekutiv është Shërbimi Përmbarimor (*shtetëror ose privat*).

Për të detyruar palën debitore që në këtë rast është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ligji parashikon mjete ligjore për përmbaruesin, përmes të cilave ai arrin të ekzekutojë titullin ekzekutiv si p.sh. bllokimi i llogarive të institucionit, marrjen e masave ndaj personave përgjegjës deri në kallzim penal të personave që pengojnë ekzekutimin, këto për të mundësuar arritjen e qëllimit që në rastin konkret është vijimi i punës së nëpunëses civile ***** në pozicionin e punës “*Specialiste pranë Sektorit të Administratës dhe Shërbimit në Degën e Doganës Durrës*”.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”, i ndryshuar, nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar dhe nenin 16, pika “6”, të Rregullores “*Për procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të kërkesës nr. 402/1 prot., datë 19.03.2021, të nëpunëses ***** , në lidhje me disa pretendime për parregullsi dhe shkelje të lejuara në zbatimin të nenit 510/a, të Kodit të Procedurës Civile dhe

nenit 33, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për mos ekzekutimin e një vendimi gjyqësor për sigurim padie.

2. Të njoftohet për këtë vendim kërkesja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha